

Për prindër dhe kujdestarë të nxënësve dhe nxënëseve
të shkollave fillore si dhe shkollave të asociuara fillore
dhe reale të Rheinland-Pfalzit

Të dashur prindër, të dashur kujdestar të fëmijëve,

të hënën e ardhëshme do të duhej të fillonte mësimi i kombinuar për fëmijët e klasës së parë deri në klasën e katërt. Ju dhe fëmijet e juaj keni qenë të lumtur për këtë ditë. Shkollat tani më kanë bërë përgatitjet e duhura me angazhim maksimal për këtë ditë.

Mirpo duke pas parasyshë zhvillimet me infeksionet dhe situatën aktuale me pandeminë, fatkeqsisht nuk kemi mundur që të bëjmë këtë hap për hapje më të madhe (lirim të masave). Ditën e djeshme në Baden-Württemberg- fqinjë janë lajmëruar 13 raste me variantin e ri të virusit. Për këtë arsye ne jemi konsultuar dje në mbrëmje dhe sot në mëngjes, me ekspertët e universitetit të mjeksisë në Mainz, për gjendjen e përkeqësuar të infeksioneve.

Për derisa ekspertët sikur se edhe ne, e preferonim si të arsyeshëm kalimin në mësim të kombinuar, për faktin se numri i të infektuarve në republikë ka rënë nën 100 dhe është gjithnjë e në rënje duke parë zhvillimet më të reja me infeksionin në Baden-Württemberg, kanë keshilluar që kalimin e planifikuar në mësim të kombinuar e me këtë një hapje më të gjërë e me shumë kontakte edhe në Rheinland- Pfalz. Tani për tani të mos zbatohet. Në fakt shifrat janë duke shkuar gjithnjë në drejtimin e duhur dhe shumë pozitiv.

Për arsye se lloji, si dhe rëndësia e këtij varianti të ri të virusit për çastin janë të panjohura, ekspertët kanë keshilluar për kujdes me hapjet me të mëdha. Gjendja duhet vlersuar serish, sa të kemi informata më të sakta për këtë. Prandaj ne do t'i zbatojmë këto këshilla.

Unë e kam theksuar gjithnjë, që kalimi në mesim të kombinuar me 1 shkurt 2021 do të mvaret nga gjendja me infeksionet. Ne këtë kohë, këtë nuk mund të themi me siguri të mjaftueshme. Veprimi i ngadaltë i pa ngutur është tani këshilla më e mençur, në mënyrë që mos t'i rrezikojmë (dëmtojmë) sukseset e arritura gjer më tani. Për këto arsye në vijim do te vazhdohet me mesim në distancë. Përkujdesja emergjente do te afrohet si deri me tani, duke pasur kujdes rregullat e higjenës. Kunder kësaj të fundit sipas deklaratave të ekspertëve dhe te suksesshme nuk ka as një dyshim, për arsye te koncepteve të mira higjenike, rregullat e distances fizike si dhe obligimi i mbajtjes së maskës. Për nxënësit e nxënëset e klasëve ma të larta, në ërveç kësaj dhe duke u mbështetur në rregullat e transportit publik dhe transportit të nxënësive, do të specifikojmë obligimin e mbajtjes së maskës dhe do të urdhërojmë mbajtjen e maskës kirurgjike në përkujdesjen emergjente.

Më vjen shumë keq që është dashtë të terhiqemi nga qëllimi i hapjes së mësimit të kombinuar. Besoj se mund t`a paramendoni se sa të vështirë e kemi pasë ta marrim këtë vendim. Si për ju dhe fëmijët tuaj ashtu edhe për shumë mësues e mësuese nuk ka qënë e lehtë. Vendimi është rrugë e drejtë dhe përshtatet me veprimet tona që nga fillimi i pandemisë që të kemi aq shumë shkollë për sa mund të mbajmë përgjegjësi .

Ne do t'ju informojmë edhe përmes shkollave të juaja, në ditët në vijim për hapat vijues.

Përshendetje nga zemra

Dr. Stefanie Hubig